

LIGJI NR. 04/L - 221

PËR INSTITUTIN E KOSOVËS PËR ADMINISTRATË PUBLIKE

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR INSTITUTIN E KOSOVËS PËR ADMINISTRATË PUBLIKE

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim rregullimin e organizimit, funksionimit dhe përgjegjësitë e Institutit të Kosovës për Administratë Publike (në tekstin e mëposhtëm: IKAP).

Neni 2

Fushëveprimi

1. Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) është përgjegjës për zbatimin e politikave dhe strategjive të trajnimit, aftësimit profesional dhe zhvillimit të kapaciteteve në Shërbimin Civil.
2. IKAP ofron shërbimet nga paragrafi 1 i këtij neni për të gjitha institucionet e Shërbimit Civilë të nivelit qendror dhe lokal.
3. IKAP gjithashtu mund të ofrojë shërbimet nga paragrafi 1 i këtij neni edhe për personat fizik dhe juridik.

Neni 3

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

- 1.1. **Ministria** – Ministria e përgjegjëse për administratë publike;
- 1.2. **Ministri** - Ministri përgjegjës për administratë publike;
- 1.3. **IKAP**- Instituti i Kosovës për Administratë Publike;
- 1.4. **Institucionet e Shërbimit civilë** - të gjitha institucionet e përcaktuara në Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë ligj kanë kuptimin e njëjtë me përkufizimet e dhëna në Ligjin nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

Neni 4

Statusi Juridik

IKAP është organ qendror i administratës shtetërore i cili funksionon në kuadër të Ministrisë.

Neni 5 **Funksionet e IKAP-it**

1. Funksionet e IKAP-it janë si në vijim:

- 1.1. këshillon dhe mbështet Ministrinë gjatë përgatitjes së strategjive për aftësimin e nëpunësve civilë dhe zbaton këto strategji pas miratimit të tyre;
- 1.2. identifikon dhe vlerëson, në mënyrë periodike, nevojat për aftësimin e nëpunësve civil të Kosovës në nivelin qendror dhe lokal;
- 1.3. bënë grumbullimin e planeve të trajnimit, pas vlerësimit vjetor të punës dhe i integron këto plane në planin vjetor të trajnimit deri më 30 maj të çdo viti;
- 1.4. harton programe të përshtatshme të aftësimit që përmbushin nevojat e identifikuara dhe vlerëson rezultatet e programeve të aftësimit të organizuara për këtë qëllim;
- 1.5. ofron trajnime për aftësimin e nëpunësve civilë në nivelin qendror dhe lokal;
- 1.6. harton planin afatmesëm dhe afatgjatë të IKAP-it;
- 1.7. koordinon aktivitetet me institucionet në nivelin qendror e lokal si dhe aktivitetet e donatorëve në fushën e aftësimit në shërbimin civil;
- 1.8. kryen hulumtime, organizon forume dhe diskutime për nevojat e trajnimit si dhe zhvillimit të nëpunësve civilë;
- 1.9. mban të dhëna për trajnime dhe programe që realizohen në IKAP.

2. IKAP bashkëpunon me institucionet tjera, krijon dhe mirëmban qasje në rrjete profesionale vendore dhe ndërkombëtare që kanë njohuri dhe përvojë në fushën e zbatimit të politikave dhe strategjive të trajnimit, aftësimi profesional dhe zhvillimit të kapaciteteve.

Neni 6 **Struktura Organizative e IKAP-it**

1. Struktura Organizative e IKAP-it përbëhet nga:

- 1.1. Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm;
- 1.2. Drejtoratet; dhe
- 1.3. Sektorët.

2. Organizimi i brendshëm dhe sistematizimi i vendeve të punës në IKAP bëhet në pajtim me Ligjin nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore.

Neni 7 **Drejtori i Përgjithshëm**

1. IKAP drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili emërohet në pajtim me Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe i përgjigjet drejtpërdrejtë Ministrit kompetent për administratën publike.

2. Drejtori i Përgjithshëm është kompetent:

- 2.1. për administrimin dhe menaxhimin e përgjithshëm të IKAP;

2.2. për udhëzime dhe këshilla të sakta, të paanshme dhe profesionale lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me detyrat dhe përgjegjësitë e IKAP-it;

2.3. për nxjerrjen e vendimeve dhe udhëzuesve lidhur me funksionimin e IKAP;

2.4. për menaxhimin e resurseve dhe zbatimin e një sistemi të menaxhimit të cilësisë.

3. Drejtori i Përgjithshëm jo më vonë se me 1 mars të çdo viti kalendarik, ia dorëzon Ministrit një raport në të cilin pasqyron hollësisht arritjen e rezultateve gjatë vitit të kaluar.

Neni 8 **Kategoritë e grupeve për aftësim**

1. IKAP ofron programe trajnimi dhe aftësimi për kategoritë vijuese:

1.1. nëpunësit civil të karrierës dhe jo të karrierës të punësuar në organet e administratës të nivelit qendror dhe lokal;

1.2. kategoritë tjera sipas kërkesave të personave fizik dhe juridik, të cilat rregullohen me akt nënligjor të propozuar nga Ministria dhe miratuar nga Qeveria.

2. Për kategoritë e parapara në nënparagrafin 1.2. të këtij neni, IKAP mund të ofroj trajnime nëse siguron mjete të mjaftueshme financiare.

3. Kërkesat nga kategoritë e parapara në nënparagrafin 1.2. të këtij neni duhet të miratohen nga Drejtori i Përgjithshëm i IKAP-it.

Neni 9 **Programet e aftësimit**

1. IKAP përgatit dhe zbaton programe aftësimi si në vijim:

1.1. trajnimi hyrës gjatë periudhës provuese;

1.2. trajnimi për zhvillimin e karrierës;

1.3. trajnimi për përshtatje profesionale, në rastet e ndryshimit të kërkesave të vendit të punës;

1.4. trajnimi me karakter të posaçëm për kryerjen e detyrave të veçanta;

1.5. trajnimi për zhvillimin e njohurive profesionale;

1.6. trajnimi për trajner;

1.7. trajnimet dhe testimet e obligueshme të cilat janë paraparë me legjislacionin në fuqi.

2. Për programet e aftësimit nga paragrafi 1 i këtij neni, IKAP lëshon certifikata pas përfundimit të suksesshëm të programeve aftësuese.

3. Për trajnimet dhe testimet e obligueshme nga nënparagrafi 1.7 i këtij neni, çështjet e organizimit të tyre, përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Qeveria, bazuar në një studim fizibiliteti për aplikimin e trajnimeve dhe testeve të obligueshme në shërbimin civil të Kosovës.

4. IKAP, gëzon të gjitha të drejtat në pajtim me legjislacionin në fuqi, lidhur me pronësinë intelektuale për programet e zhvilluara të trajnimit.

Neni 10

Koordinimi i programeve te trajnimit

1. IKAP koordinon aktivitetet e trajnimit me institucionet e nivelit qendrore e lokal si dhe organizatat donatore në programet e trajnimit për nëpunësit civil me fokus të veçantë për programet e aftësimit të parapara në nenin 9, paragrafi 1 të këtij ligji.
2. IKAP krijon dhe mirëmban bazën e të dhënave për programet e zhvilluara te trajnimit.

Neni 11

Trajnerët e IKAP-it

1. Për nevojat e zbatimit të programeve të aftësimit IKAP angazhon trajnerë.
2. Pagesa e trajnerëve të angazhuar bëhet nga Buxheti i IKAP-it.
3. Kushtet për angazhimin e trajnerëve, kategorizimin, dhe mënyrën e pagesës do të rregullohen me akt nënligjor të propozuar nga Ministria dhe miratuar nga Qeveria.

Neni 12

Aftësimi profesional në IKAP

1. Në pajtim me nenin 10 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, IKAP organizon programe të aftësimit profesional në fushën e administratës publike.
2. Për zhvillimin e programeve të aftësimit profesional, IKAP mund të hyj në partneritet me bartësit e arsimit të lartë të cilat janë të akredituara dhe që veprojnë brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës.

Neni 13

Buxheti

1. IKAP financohet nga:
 - 1.1. Buxheti i Kosovës;
 - 1.2. kontributet e donatorëve, të cilat mund të jenë të pjesshme (bashkëfinancim) dhe të plota.
2. Menaxhimi i kontributeve të donatorëve bëhet me marrëveshje mirëkuptimi në mes IKAP-it dhe donatorëve.

Neni 14

Të hyrat vetanake

1. IKAP mund të krijoj të hyra nga shërbimet e ofruara në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë si dhe në pajtim me këtë ligj.
2. Për ushtrimin e funksioneve dhe përgjegjësi të veta, IKAP mund të kontrakttoj shërbime nga palë të tjera në pajtim me legjislacionin në fuqi.
3. Llojet dhe lartësia e taksave dhe tarifave nga këto shërbime rregullohen me akt nënligjor, i cili propozohet nga Ministri dhe miratohet nga Qeveria.
4. Shpenzimi i të hyrave vetanake të IKAP-it bëhet në pajtim Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Neni 15
Aktet nënligjore

Aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji nxirren brenda gjashtë (6) muajsh nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 16
Dispozitat kalimtare

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut nr. 2003/25.
2. Deri në miratimin e akteve nënligjore që dalin nga ky ligj, vazhdon të zbatohet Udhëzimi Administrativ 2004/9 për pagesat e trajnerëve të angazhuar në Institutin e Kosovës për Administratë Publike.

Neni 17
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L -221
20 mars 2014

Shpallur me dekretin Nr. DL-014-2014, datë 07.04.2014 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga